

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISE TIRANË  
NOTERE Ilirjana ÇELA

Nr. 1035 Rep.  
Nr. 103 Kol.



D Ë S H M I

TRASHËGIMIE LIGJORE

Në Tiranë, sot me datë pese Gusht, dymijë e nëntëmbëdhjetë (05.08.2019), Ditën e Hene, ora 15:30 u paraqit përpara meje dhe më kërkoi lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë shtetasë :

KËRKUES	Gjysho MERKO, atësia Krenar, amësia Entela, lindur në Berat, më 23.01.1997, banues në Tiranë, Rr. Asim Vokshi 90/1, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti me nr personal J70123042R.
OBJEKTI	Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin Krenar Gjysho MERKO.
Baza ligjore	Nenet 316, 317, 318, 320, 348; 360; 361 e vijues të K. Civil.i ndryshuar, Ligji Nr.110/2018 datë 20.12.2018 Për Noterinë,

Unë, Noterja pasi dëgjova kërkuesin Gjysho Merko dhe shqyrtova dokumentacionin e paraqitur

VËRËJ SE:

Rrethanat e çështjes:

Kërkuesi Gjysho Merko, në cilësinë e djalit të të ndjerit, ka depozituar në zyrën noteriale, një kërkesë me anë të së cilës kërkon “Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore” të babait të tij, trashëgimlënësit, të ndjerit Krenar Merko”.

Referuar Nenit 360 të Kodit Civil, ai legjitimohet për paraqitjen e kërkesës para meje, noteres, pasi ai ka interes të ligjshëm në këtë kërkim, cit: “Trashëgimtarët ligjorë janë: fëmijët, fëmijëve bashkëshorti, prindërit, vëllezërit, e motrat; fëmijët e vëllezërvë e të motrave të para vdekur, gjyshi, e gjyshja dhe të paralindurit, e të tjerë; personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit, e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgim sipas rradhës së caktuar në këtë Kod”

Ligji i zbatueshëm

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë në nenit 318/1 dhe 348 paragrafi 1 dhe 2 të tij përcakton se : “Trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi. Në rastin e shpalljes së personit të vdekur, trashëgimia çelet ditën kur, sipas vendimit gjyqësor, personi konsiderohet i vdekur” Neni 348 cit “Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgimi caktohen në dëshminë e

*trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, pas paraqitjes së certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod dhe në Ligjin për Noterinë. Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri i njësisë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi....”*

*Prandaj, duke qenë se vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit ka qenë në Tiranë, me adresë : Rr. Asim Vokshi 90/1, Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë, atëherë arrihet në përfundimin se kompetente për të lëshuar dëshminë e trashëgimisë është Dhoma e Noterisë Tiranë.*

*Bazuar në Nenin 318/2 të Kodit Civil cit: “Trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur” dhe Referuar kohës së vdekjes së trashëgimlënësit, konkretisht më 02.07.2019, arrihet në përfundimin se ligji që rregullon trashëgiminë e saj është pikërisht Kodi Civil në fuqi, i cili në nenin 1168 të tij përcakton si datë të hyrjes në fuqi atë 1 nëntor 1994.*

Kodi Civil në nenin 360 të tij të sipërcituar dhe në nenin 361/1 të tij përcakton së : “*Në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paafë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta. Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është i përjashtuar nga trashëgimi, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij, dhe kur për shkaqet e mësipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim. Në këtë rast, pjesa e prindit që nuk trashëgon ndahet ndërmjet të paslindurve në pjesë të barabartë”.*

Nga dokumentet e paraqitura dhe të depozituara në dosjen (çertifikata e vdekjes, çertifikatat familjare, çertifikatat personale të trashëgimtarëve të administruara në dosje), si dhe nga shpjegimet e kërkuesit, rezulton e provuar se :

Trashëgimlënesi Krenar MERKO, atësia Gjysho, amësia Rahime, lindur në Berat, më 19.12.1966, me banim në Rr. Asim Vokshi 90/1, Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë, me shtetësi Shqiptare, i Martuar, mashkull, ka ndërruar jetë më datë 02.07.2019, vërtetuar me certifikatën e vdekjes nr 015074653 datë 09.07.2019, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Nj. Bashkiake Nr. 9, Tiranë. Vdekja e tij përbën ngjarjen juridike dhe shkakun ligjor për çeljen e trashëgimit të tij.

Nga pyetjet që iu bënë kërkuesit dhe nga shpjegimet e dhëna nga ai, nuk rezulton që i ndjeri të ketë lënë testament, fakt të cilin e konfirmon dhe Regjistri Kombëtar i Noterëve, në bazë të kërkesës së bërë nga unë, noterja, me Nr. 126783 datë 31.07.2019, nga ku rezulton se i ndjeri nuk ka lënë testament dhe për rrjedhojë, për trashëgimin e tij zbatohet ligji rregullues mbi trashëgimin ligjor, në përputhje të nenit 317 të Kodit Civil që shprehet: “*Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënesi nuk ka bërë testament ose ka bërë për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm*”

Sipas çertifikatës familjare datë 05.08.2019 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Arkiva, Bashkia Tiranë, sipas regjistrimit te popullesise ngå viti 2010 dhe Çertifikates se Martesës nr 014610863 date 05.08.2019, sipas regjistrat te vitit 1974, rezulton se i ndjeri ka qënë i martuar me shtetasen Entela Merko, atësia Hekuran, amësia Zyhra, lindur me 06.12.1972 ne Berat, dhe nga kjo martese u kanë lindur tre fëmijë, përkatësisht :

**1 - Enka Merko**, atësia Krenar, amësia Entela, lindur më 05.05.1995 në Berat, banues në Tiranë, Rr. Asim Vokshi, Nj. Adm. 9, Femer, madhore, beqare, me shtetësi shqiptare, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me numër personal J55505051P,

**2 - Gjysho Merko**, atësia Krenar, amësia Entela, lindur më 23.01.1997 në Berat, banues në Tiranë, Rr. Asim Vokshi, Nj. Adm. 9, Mashkull, madhor, beqar, me shtetësi shqiptare, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me numër personal J70123042R.

**3 - Kristjan Merko**, atësia Krenar, amësia Entela, lindur më 25.09.2001 në Berat, banues në Tiranë, Rr. Asim Vokshi, Nj. Adm. 9, Mashkull, minoren, beqar, me shtetësi shqiptare, me numër personal K10925053P.

Referuar nenit 361 të Kodit Civil :

*“Trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë janë: fëmijët o fëmijët e fëmijëve o të paslindurit e tyre si dhe bashkëshorti pasjetues.*

Gjithashtu rezulton se nuk ka lënë persona të paaftë për punë ose në ngarkim të saj dhe që ka bashkëjetuar me të për të paktën 1 vit para vdekjes.

Prandaj, si rezultat i faktave të sipërtreguara, rezulton se në momentin e çeljes së trashëgimisë për trashëgimlënësit Krenar Merko, në trashëgim do thirren bashkëshortja dhe fëmijët e tyre, te cilët do të trashëgojnë, babain e tyre,

Në këto rrethana, trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënësit Krenar Merko janë bashkëshortja dhe fëmijët e tij, të cilët trashëgojnë të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejtat pasurore të pasurisë trashëgimore, por edhe detyrimet përkatëse të kësaj pasurie, brenda masës së pasurisë së trashëguar, përkatësisht :

**1 - Entela Merko**, atësia Hekuran, amësia Zyhra, lindur më 06.12.1972 në Berat, banuese në Tiranë, Rr. Asim Vokshi, Nj. Adm. 9, Femer, madhore, e ve, me shtetësi shqiptare, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me numër personal H26206025T, bashkëshortja, e cila do trashegoje  $\frac{1}{4}$  pjesë.

**2 - Enka Merko**, atësia Krenar, amësia Entela, lindur më 05.05.1995 në Berat, banues në Tiranë, Rr. Asim Vokshi, Nj. Adm. 9, Femer, madhore, beqare, me shtetësi shqiptare, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me numër personal J55505051P, e bija, e cila do trashëgojë  $\frac{1}{4}$  pjesë.

**3 - Gjysho Merko**, atësia Krenar, amësia Entela, lindur më 23.01.1997 në Berat, banues në Tiranë, Rr. Asim Vokshi, Nj. Adm. 9, Mashkull, madhor, beqar, me shtetësi shqiptare, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me numër personal J70123042R, i biri, i cili do trashëgojë  $\frac{1}{4}$  pjesë.

**4 - Kristjan Merko**, atësia Krenar, amësia Entela, lindur më 25.09.2001 në Berat, banues në Tiranë, Rr. Asim Vokshi, Nj. Adm. 9, Mashkull, minoren, beqar, me shtetësi shqiptare, me numër personal K10925053P, i biri, i cili do trashëgojë  $\frac{1}{4}$  pjesë.

Nga certifikatat personale të trashëgimtarave të sipërcituar të trashëgimlënësit, të administruara nga unë noterja, rezulton se në momentin e çeljes së trashëgimisë, ata rezultojnë të gjallë e si të tillë përfshihen në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënësit.

Nga verifikimet nuk rezulton që ndonjë nga trashëgimtarët e lartpërmendur të ketë hequr dorë nga trashëgimi, të jetë shpallur i padenjë për të trashëguar, apo të jetë përjashtuar nga trashëgimia.

Gjithashtu, nga pyetjet që iu bënë kërkuesit Gjysho Merko, ai më deklroi se trashëgimlënësi nuk ka pasur fëmijë jashtë martese, të birësuar, nuk ka pasur persona në ngarkim dhe nuk ka trashëgimtarë të tjerë ligjorë, përvèç atyre të pasqyruar në certifikatat e trungut familjar dhe të pasqyrura në certifikatat personale të depozituara prej tij.

Për sa më sipër, trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit Krenar Merko janë trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë, konkretisht : Entela Merko, Enka Merko, Gjysho Merko dhe Kristjan Merko, të cilët trashëgojnë të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejtat pasurore të pasurisë trashëgimore, por edhe detyrimet përkatëse të kësaj pasurie, brenda massës së pasurisë së trashëguar.

### PËR KËTO ARËSYE

Unë, Noterja Ilirjana I. Çela, bazuar në Nenet 111, 112, 113 të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Per Noterinë" dhe nenit 348 K.C.

### V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës.
- Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësit **Krenar MERKO**, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë dhe pjesët e tyre takuese :

Trashëgimtarët

Emër Atësia Mbiemri	Pjesa që trashëgojnë
1 - Entela Hekuran MERKO	1/4
2 - Enka Krenar MERKO	1/4
3 - Gjysho Krenar MERKO	1/4
4 - Kristjan Krenar MERKO	1/4

të cilët trashëgojnë të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënësive dëshmi që trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë dëshmojnë

të drejtat pasurore të kësaj pasurie, *sipas pjesëve të treguara më lart*, dhe po në këto raporte edhe për detyrimet përkatëse të pasurisë trashëgimore.

- Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Gjykatë brenda afatit ligjor 15 ditor, afat që fillon nga e nesërmja e shpalljes.

Ky vendim përpilohet ne 7 kopje originale, me përbajtje të njëjtë, nga të cilat një kopje e mban noteri, tre kopje e aktit iu dha kërkuesit, i cili mori njoftim për regjistrimin e saj në institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme (Z.R.P.P. Tirane dhe Berat) brenda afatit 30 ditor nga data e lëshimit të saj, ndërsa kopjet e tjera u arkivuan në Zyrën e Noterisë në pritje të térheqjes së saj nga trashëgimtarët e tjerë ligjore.

Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrithit të trashëgimtarëve ne çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme (Z.R.P.P.) nuk mund të cenojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituar gjatë martesës.

U shpall në Tiranë, sot më 05 Gusht 2019

NOTERE